



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:105877

Datë: 07.07.2021

Numri i dokumentit: 01969132

P. nr. 265/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarve A. H. nga Gjakova dhe E. R. nga Gjakova për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 269 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr.481/21 të datës 28.05.2021, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me **dt.07.07.2021**, murr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP në Gjakovë PP/II.nr.481/21 e datës 28.05.2021 dhe kjo Gjykatë, jep këtë :

URDHËR NDËSHKIMOR

Të akuzuarit:

1.A. H., data e lindjes . . . , në Gjakovë, Rr.”. . .”, nr.137/2-Gjakovë, nga i ati L. dhe e ëma F., e vajzërisë B., i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme, kuzhinier, i gjendjes se mesme ekonomike, me numër personal . . . , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

2.E. R., data e lindjes . . . , në Gjakovë, Rr.”. . .”, nr.. . . Gjakovë, nga i ati B. dhe e ëma K., e vajzërisë K., i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme, moler, i gjendjes se mesme ekonomike, me numër personal . . . , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

J a n ë f a j t o r

Sepse :

-me dt.16.03.2021, rreth orës 19:40/h, në Rr. “. . .”, në Gjakovë, saktësisht në përball shkollës së muzikës “. . .”, duke vepruar në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore Nr.02/L-128, duke vepruar në bashkëkryerje, pa autorizim kanë poseduar substancë narkotike e llojit marihuanë, në atë mënyrë që pas një kontrole rutinore nga ana e zyrtarëve Policor ndaj personave, të pandehurve A. H. dhe E. R. u është gjetur një cigare (Joint) e mbushur me substancë narkotike e llojit Kanabis (marihuanë) që përmban Tetrahideokanabioli (THC), me peshë neto:0.26 gram, të cilën e kishin blerë dhe konsumuar së bashku, e cila me rastin e kontroles është sekuestruar nga ana e hetuesve policor të njësisë për hetimin e trafikut me narkotik- Gjakovë.

-me çka kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 269 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, nenit 269 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe nenit 365 të KPPK-së, -së, të akuzuarve iu shqipton;

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit **A. H.**, dënim me gjobë në shumën prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Të akuzuarit **E. R.**, dënim me gjobë në shumën prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së ,atëherë të njëjtëve do t'ju zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) ditësh ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej nga 20,-€(njëzetë)euro.

Detyrohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej nga 40,00 € , në afat prej 15 ditëve ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë në.

Gjykata bazuar në nenin 269 par.3 të KPRK-ës, të akuzuarit i :

Konfiskohet substanca narkotike e llojit kanabisë (marihuanë) me peshë neto prej 0.26 gr .e cila është sekuestruar me dt. 16.03.2021 ,e që është objekt i kësaj vepre penale.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP/II.nr.481/21 e datës 28.05.2021, ndaj të akuzuarve A. H. dhe E. R. që te dy nga Gjakova ,për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 269 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Komfor nenit 493 të KPPK-së , PTH në Gjakovë , kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarve, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtëve t'ju shqiptohet dënimi me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së nenit 269 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e cila dispozitë për kryesit e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë në 1 (një) vit .

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-së dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Kallëzimi penal me nr. Të rastit 2020-DHTN-99 dt.17.03.2021
- Raporti i oficerit A. B., i dt.16.03.2021;
- Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, me nr.ref. AKF/2021-1103/2021-1016, të dt.26.04.2021;
- Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, dt.16.03.2021;
- Deklarata e të pandehurit A. H., e dhënë në Polici me dt.16.03.2021;
- Deklarata e të pandehurit E. R., e dhënë në Polici me dt.16.03.2021;
- Fotografitë si dhe shkresat tjera në lëndë.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se të akuzuarit janë kryes të veprës penale për të cilën akuzohen.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 38 të KPRK-së në mënyrë që të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për konfiskimin substancës narkotike e llojit Kanabis (marihuanë) me peshë neto prej 0.26 gr, , që është objekt i kësaj vepre penal ,Gjykata e mori komform nenit 269 par.3 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30 euro , është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.,

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.265/21 të dt. 07.07.2021

Sekretarja juridike:
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës ,Gjyqtares të kësaj Gjykate. Nëse e pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.

Numri i lëndës: 2021:105877
Datë: 07.07.2021
Numri i dokumentit: 01969132